
Analizë e Raportit Vjetor të KOSTT për vitin 2017

HULUMTIM PARLAMENTAR

10/2018



Analizë e Raportit Vjetor të KOSTT për vitin 2017

Autor:	INDEP
Programi:	Zhvillim i qëndrueshëm
Publikimi:	Qershor 2018
Foto e ballinës:	Pexels



Zhvillimi i Qëndrueshëm
Sustainable Development

Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Përmbajtja

Hyrje.....	3
Përmbajtja dhe kualiteti i raportimit.....	4
Baza ligjore.....	4
Organizmi institucional.....	4
Kompensimi i bordit.....	5
Projektet kapitale.....	6
“Kosova e Re”.....	7
Përfundime.....	8

Hyrje

Instituti për Politika Zhvillimore në kuadër të punës mbështetëse për Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, ka shqyrtuar dhe analizuar raportin vjetor të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) për vitin 2017. Puna e INDEP është mbështetur në parimet e pavarësisë, paanshmërisë dhe hulumtimit të pavarur.

Në vitin 2016, Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri ishte përballur me një dilemë në vendimmarrje. Në komentet që Sekretariati i Komitetit të Energjisë kishte dërguar për, në atë kohë draftin e Ligjit Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, kërkohej medoemos që bordin e prodhuesit (KEK-ut) dhe operatorit të transmisionit (KOSTT) të mos e zgjedhë organi i njëjtë institucional (Qeveria). E gjitha kjo për të mbështetur parimet e liberalizimit të tregut dhe ofrimit të kushteve për një konkurrencë sa më të drejtë në treg.

Duke qenë në fazën e shqyrtimit në Kuvend dhe me kohën që nuk ishte e mjaftueshme, Komisioni ndërroi disa dispozita duke ia kaluar pronësinë e KOSTT Kuvendit të Republikës së Kosovës por jo edhe duke i ndërruar statusin e ndërmarrjes publike. Edhe pse për nga natyra Operatori i Tregut dhe Transmisionit kryen një shërbim publik, që është karakteristikë e ndërmarrjeve publike, kalimi i pronësisë së ndërmarrjeve publike tek Kuvendi i Republikës për INDEP ishte një veprim që mund të nxiste dilema kushtetuese.

Republika e Kosovës do t'i ketë në pronësi të vet të gjitha ndërmarrjet në Republikën e Kosovës që janë ndërmarrje në pronësi publike. Të gjitha obligimet që kanë të bëjnë me këto të drejta pronësore do të jenë obligime të Republikës së Kosovës. Qeveria e Kosovës mund të privatizojë, të japë me koncesion ose të japë me qira ndërmarrjet në pronësi publike në mënyrën e rregulluar me ligj.¹

Megjithatë, duke qenë kërkesë e procesit të integritit dhe implementimit të qëllimeve të pakos së tretë të legjislacionit në fushën e energjisë, Kuvendi pranoi që një ndërmarrje publike të vepronte në bazë të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike por zgjedhja e bordit, pronësia dhe raportimi ti kalojnë Kuvendit. Kësisoj, ky është raporti i parë që Komisioni parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal e merr nga KOSTT.

Duke u bazuar në Manualin për Raportim të Agjencive të Pavarura, një dokument i hartuar me iniciativën e Komisionit në vitin 2014 dhe i cili është shpërndarë tek të gjitha agjencitë që i raportojnë Kuvendit të Kosovës, raporti i KOSTT i përmbahet pjesërisht këtij manuali si strukturë, dhe ofron një mori të dhënash rreth funksionimit të KOSTT, tregut dhe operatorëve të tij, bazës ligjore dhe sfidave për të ardhmen.

¹ Kushtetula e Republikës së Kosovës, (2008), Neni 160, Ndërmarrjet në Pronësi Publike, paragrafi 1, faqe 65, Prishtinë: GZRKS.

Përmbajtja dhe kualiteti i raportimit

Edhe më tutje ka një raportim jo koherent dhe jo të unifikuar. Në njëërën anë ka një raportim të Bordit të Drejtorëve e në anën tjetër edhe Kryeshefi Ekzekutiv bënë një raportim veçmas. Kjo formë e raportimit jokohorent nuk është e përshtatshme për të realizuar transparencën dhe informimin e drejtë të deputetëve të Kuvendit. Në raporte vjetore, nevojitet një frymë e përgjithshme e raportimit e jo raporti të jetë një përmbledhje copëzash të raportimit.

Një tjetër element që duhet përmirësuar në raportet e ardhshme është gjuha e raportit. KOSTT duhet ta kuptojë audiencën përpara se ta përpiloj raportin. Raporti vjetor i KOSTT i drejtohet deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe opinionit të gjerë. Gjuha teknike dhe termat shkencorë e teknik në raport janë vështirë të kuptueshëm për dikë që nuk është i sektorit të energjisë.

Baza ligjore

Në pjesën e raportimit për bazën ligjore, KOSTT ka listuar bazën ligjore, por që nuk i është përmbajtur manualit për raportim të agjencive të pavarura pasi që bazuar në manual baza ligjore duhet të renditet e dyta në raport vjetor. Në raportin e sivjetmë KOSTT për bazën ligjore ka raportuar në aneks të raportit, e që nuk ka shpjeguar qartë se si ka ndikuar ndryshimi i ligjit, pra ndikimi i Ligjit të Energjisë Elektrike në KOSTT kompensimin e Bordit të Drejtorëve dhe raportimin, dhe emërimin e Komisionit të Auditimit, nuk vlej në pasi që të gjitha këto kompetenca ushtrohen nga Kuvendi i Kosovës. KOSTT operon në mes të një treg relativisht kompleks të energjisë elektrike, që nga prodhuesi, me KEK-un si prodhuesin kryesor deri tek furnizuesi kryesor KESCO. Kësisoj, me raportimin vjetor ka mundësi që një pjesë e madhe e shqetësimeve që kanë të bëjnë me funksionimin e njërit prej akterëve më të rëndësishëm të tregut të energjisë elektrike në Kosovë.

Organizmi institucional

Organizimi institucional i KOSTT është raportuar pjesërisht në përputhje me standardet e raportimit dhe kërkesat për raportim në Kuvendin e Kosovës. Sa i përket bordit, raporti përmban të dhënat për përbërjen e tij, dhe në krahasim me raportin e kaluar vërehet një përmirësim pasiqë ky raport përmban të dhëna rreth mandatit të anëtarëve të bordit dhe kohës se kur u kalon mandate. Po ashtu edhe tek ekzekutivi njësoj sikur në raportin e vitit të kaluar përveç të dhënave për përbërjen e menaxhmentit të lartë nuk ka ndonjë të dhënë për menaxhmentin e mesëm, e po ashtu nuk përmban të dhëna rreth mandatit të ekzekutivit dhe kohën kur i skadon mandati.

Në raport KOSTT tregon numrin e punëtorëve si dhe sqaron lëvizjen e numrit të punëtorëve nga 360 i cili ishte në janar të vitit 2017 në 347 punëtor në dhjetor të vitit 2017, zvogëlim ky i cila ka ndodhë për shkak të pensionimit të punëtorëve, ndërsa nuk sqaron se a është e nevojshme plotësimi i këtij numrit të punëtorëve të pensionuar, apo shtimi i punëtorëve të rinj.

Ky raport përmban pjesën e trajnimit të personelit, por nuk jep tabelen e specifikuar të trajnimeve, por vetëm tregon se janë trajnuar nga Zyra e Sigurisë dhe Mjedisit 151 punëtorë apo gjithsej 302 orë trajnim, trajnimi i stafit operativ të Qendrës Dispeqerike Nacionale sipas kërkesave nga

doracaku ENTSO-E, është investuar në zhvillimin profesional të punëtorëve me realizimin e trajnimeve, pjesëmarrjen në seminare, workshope dhe grupe punuese. Po ashtu, është e rëndësishme të pasqyrohet edhe ndikimi i këtyre trajnimeve në përmirësimin e performancës së stafit apo edhe në arritjen e objektivave strategjike, pasi që përfundimisht, trajnimi i punonjësve realizohet me qëllim të arritjes së objektivave. Këtë, ky raport nuk e ka ofruar.

Kompensimi i bordit

Në raport është përshkruar se secili anëtar i bordit, në vitin 2017 ka marrë shtesë nga mbi 4700 deri tek mbi 5500 euro shtesë për performancë të ndërmarrjes. Gjithashtu, bordi, siç është përshkruar në raport, merr edhe 90 euro kompensim për shpenzimet e ushqimit dhe udhëtimit për mbledhje sipas vendimit të Bordit nr. 161013-II/4/1. Ky vendim nuk është publik dhe nuk ka një shpjegim se cila është arsyeja përse duhet paguar shpenzimet e udhëtimit dhe ushqimit për anëtarët e bordit kur dihet se pjesëmarrja në mbledhje të bordit është pjesë e përshkrimit të vendit të punës. Gjithashtu, cila është arsyeshmëria e lartësisë së shumës prej 90 eurosh.

Kjo pagesë, është e paligjshme në bazë të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike të cilit, të cilit KOSTT i nënshtrohet sipas Ligjit Nr. 05/L - 085 për Energjinë Elektrike.

NP është përgjegjëse për pagimin e të gjithë kompensimit për drejtorët e saj vetëm nga pagesat e parapara me Vendimin e Aksionarit. Drejtorët e NP nuk do të marrin asnjë kompensim ose përfitim tjetër nga NP.²

Gjithashtu, paga që marrin anëtarët e Bordit, është praktikisht pagesë në emër të kohës dhe shpenzimeve që ata kanë për pjesëmarrje në mbledhje. Çfarëdo pagese tjetër ose kompensim, përbën shkelje të ligjit dhe keqpërdorim të pozitës zyrtare. Në këtë rast, ne konsiderojmë se kjo pagesë është e paligjshme dhe këto mjete duhen kthyer prapa.

Raporti, dhe çdo vendim që ka të bëjë me ndarje të mjeteve publike për «shpërblim të performancës» ose në emër të shpenzimeve të tjera, duhet arsyetuar detajisht dhe të ndërlidhet me përmbushje të misionit të KOSTT. Performancë e mirë nuk duhet konsideruar realizimi i planit, por tejkalimi i tij. Vetëm sepse ligji e lejon, nuk duhet që ndërmarrje publike dhe institucione të tjera të ndajnë mjete nga paratë publike për të shpërblyer veten ose për të ofruar pagesa për shpenzime të cilat vendi i punës i parasheh.

² Republika e Kosovës, (2008), Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr. Ligji Nr. 04/L-111 për Ndryshimin Dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike Dhe Ligjin Nr. Ligji Nr. 05/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i Ndryshuar dhe i Plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111, Neni 20.6, Prishtinë: GZRKS.

Projektet kapitale

Në raportin e KOSTT është thënë se gjatë vitit 2017 nuk ka pasur projekte të reja:

Viti 2017 karakterizohet si vit që kryesisht ka qenë i orientuar në realizimin e projekteve të filluara në vitet paraprake, të financuara nga KOSTT, KfW/KE dhe fillimi i projekteve të financuara nga BERZH/ kredi dhe buxheti vetanak i KOSTT-it. Sa i përket infrastrukturës së rrjetit të transmisionit, në vitin 2017 nuk kishte ndonjë projekt që ka filluar si projekt i ri.³

Megjithatë, edhe në implementim të projekteve ka pasur ngecje dhe tabela në vijim tregon se në fakt dy projekte që kanë pasur të përfundojnë në vitin 2017 sipas Planit Zhvillimor të Operatorit të Sistemit të Transmisionit 2014-2023 nuk kanë përfunduar implementimin sipas planit. Dhe si edhe vitin e kaluar, edhe në këtë raport nuk ka pasur shpjegime të mjaftueshme për arsyet.

Nr.	ID	Emërtimi i Projektit	Përshkrimi teknik	Arsyeja për zhvillim	Viti	Në raport thuhet vetëm:
1	T&D-L2/MIT2	NS Mitrovica 2 me linjat transmetuese 110 kV	a) Linja dyfishe 1.5km, 110 kV kycje ne linjën Vallaq-Bardhi dhe linja dyfishe 2 km kycje ne linjën Skenderaj-Vallaq. b) NS Mitrovica 2, 110/10(20)kV, 2x40 MVA fusha transformatorike ne 110 kV dhe 10(20) kV, 4 fusha te linjave 110 kV dhe fusha lidhëse 110 kV. d) objekti	Ngritja e sigurisë dhe kualitetit te furnizimit te rajonit te Mitrovicës.	Q4-2017	Paket Projektet për të cilat janë nënshkruar kontratat në vitin 2016 dhe kanë vazhduar me implementim konform kontratave janë projektet, që bashkëfinancohen nga BERZH/kredi dhe buxheti vetanak i KOSTT-it dhe të cilat duhet të zgjasin me implementim deri në

³ Raportli i KOSTT për vitin 2017, faqe 21.

			komandues me pajisjet përcjellëse			tremujorin e dytë 2019:
2	T-L2/PRISHTINA 6	Paket Projekti Prishtina 6 me kabllon e dyfishtë nëntokësore 110 kV	a) Nënstacioni i llojit GIS, 110/10(20) kV, 2x40 MVA b) fusha kabllorike 110 kV b) dy kabllor 110 kV, 1000mm ² , me gjatësi 5.5 km c) 2 fusha transformatorike ne 110 kV dhe ne 10(20)kV, 1 fushë lidhëse 110 kV. Objekti komandues me pajisjet përcjellëse	Ngritja e sigurisë dhe kualitetit të furnizimit të konsumit në qendër të Prishtinës, plotësimi i kriterit N-1, reduktimi i humbjeve teknike dhe shkarkimi nënstacioneve 110 kV të kryeqytetit.	Q4-2017	Paket Projektet për të cilat janë nënshkruar kontratat në vitin 2016 dhe kanë vazhduar me implementim konform kontratave janë projektet, që bashkëfinancohen nga BERZH/kredi dhe buxheti i vetanë i KOSTT-it dhe të cilat duhet të zgjasin me implementim deri në tremujorin e dytë 2019:

“Kosova e Re”

Më 21 dhjetor 2017, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nënshkruar kontratën për ndërtimin e termocentralit “Kosova e Re”. Duke qenë se KOSTT është pjesë monitoruese e mbledhjeve të Komitetit Drejtues të Projektit dhe është palë që do të ketë obligime brenda kontratës, nuk është dashur të heshtet në raport përkitazi me termet e kontratës dhe obligimet që ka KOSTT.

INDEP konsideron që KOSTT, si aktor shumë i rëndësishëm i tregut të energjisë, duhet t'i bashkangjes një pjesë raportit vjetor ku do të fokusohet në implikimet që do të ketë kontrata për liberalizimin e tregut, interkoneksionin me Shqipërinë, integrimin e tregut në rajon dhe integrimin e energjisë nga burimet e ripërtrishme në rrjetë. KOSTT nuk mund të qëndroj indiferent ndaj kësaj ngjarje në tregun e energjisë dhe duhet të raportoj detajisht për përgjegjësitë që ka marrë operatori dhe duke qenë organ profesional, të raportoj edhe për implikimet që do të ketë kjo kontratë në tregun e brendshëm dhe pozitën e Kosovës karrshi rajonit.

Përfundime

Raporti i sivjemë i KOSTT-it, ndonëse ka shumë informata, gjuha me të cilën janë paraqitur është me raste shumë teknike dhe vështirë e kuptueshme për një audiencë që nuk merret me energji. Gjuha e thjeshtë dhe gjithpërfshirja në informim është e domosdoshme për raportet në të ardhmen. Për më tepër, raporti jo gjithmonë ka kohezion dhe vërehet raportim me copëza nga bordi tek drejtori ekzekutiv dhe anasjelltas.

Ka një përmirësim në zbatimin e Manualit për Raportim të Agjencive dhe Institucioneve të Pavarura me Kuvendin e Kosovës. Megjithatë, pjesë të caktuara nuk janë rënditur drejtë sipas kërkesave të manualit. Baza ligjore është diskutuar tek në Aneksi i raportit dhe nuk ka pasur shpjegime të impaktit të ndryshimit të bazës ligjore dhe as të nevojës për ndryshim në të ardhmen. Për më tepër, në medie është raportuar për iniciativën e Qeverisë për të vënë KOSTT sërish nën ombrellën e saj. Për këtë, KOSTT është dashur që së paku të tregoj nëse një ndryshim i tillë do të kishte ndikim në funksionimin e saj dhe se cili ka qenë efekti pozitiv ose negativ i ndryshimit të aksionarit të KOSTT.

Tek pjesa e organizimit institucional, KOSTT nuk ka raportuar mbi nevojën ose jo për zëvendësim të punëtorëve që kanë dalë në pension me punëtor të rinjë. Në bazë të numrave, nuk janë plotësuar të gjitha pozitat që kanë dalë në pension. Për më tepër, KOSTT duhet të zhvilloj një praktikë të raportimit më të detajuar mbi kapacitetet njerëzore dhe nevojën për shtim ose zvogëlim të stafit. Edhe tek trajnimet janë shpjeguar numri i tyre por nuk është dhënë në mënyrë sistematike një tabelë me trajnimet e ndjekura dhe nevojën për trajnime shtesë dhe ndërlihdjen e tyre me performancën e përgjithshme të ndërmarrjes.

Kompensimet shtesë të anëtarëve të bordit nuk janë sqaruar sa duhet në këtë raport. Për INDEP, është detyrë edhe e Komisionit funksional, krahas atyre për Buxhet dhe Mbikëqyrje të Financave Publike që të sigurohen se shpenzimi i parasë publike po bëhet në atë mënyrë që po rritë performancën e ndërmarrjes dhe jo të shfrytëzohen hapësirat ligjore për vetëshpërbliim të anëtarëve të bordit. Në raport nuk është sqaruar cila është baza e sakt ku kalkulohet përqindja e pagesës shtesë për anëtarët e bordit. Madje, për shembull, është thënë se për shpenzime të udhëtimit dhe ushqimit jepen edhe 90 euro shtesë të cilat ne vlerësojmë se janë dhënë në kundërshtim me Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

KOSTT nuk ka filluar projekte të reja kapitale në vitin 2017. Për këtë, në raport nuk janë dhënë sqarime të mjaftueshme. Nëse ka pasur shpërbliim me shtesa për anëtarët e bordit në emër të performancës së mirë, pyetja shtrohet se për çfarë performance të mirë po flasim nëse s'ka pasur projekte të reja kapitale. Për më tepër, ne kemi vërejtur se në dy raste, as projektet në realizim s'kanë arritur të përfundohen me kohë dhe janë dhënë fare pak sqarime mbi arsyet.

KOSTT nuk mund të heshtë përballë nënshkrimit të kontratës për ndërtimin e temrocentralit «Kosova e Re». Ky zhvillim me impakt jashtëzakonisht të madh për sektorin e energjisë nuk mund të shkojë pa u trajtuar nga KOSTT-i. Për këtë, ne konsiderojmë që raporti patjetër duhet të ofrojë

një pasqyrë të impaktit që do të ketë kjo kontratë nga perspektiva e KOSTT dhe duke marrë parasysh përgjegjësitë që ka kjo ndërmarrje në tregun e energjisë elektrike në Kosovë.